



Në bazë të nenit 8 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049 ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.27/2008), nenit 6 paragrafi 2 të Ligjit mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës nr.07/L-001 ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.1/2020), Ligjit nr.07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.2/2020), nenit 52 dhe nenit 58 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.28/2008), nenit 13 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 nga 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e pestë të jashtëzakonshme, e mbajtur më datën 15.11.2024, merr këtë:

VENDIM Nr.51/2024/KG

PËR RRRITJEN E BUXHETIT NGA TË HYRAT VETANAKE PËR VITIN 2024

Neni 1

Miratohet Vendimi për rritjen e buxhetit nga të hyrat vetanake për vitin 2024 në një shumë prej **198,179.64€**.

Neni 2

Rritja e buxhetit nga të hyrat vetanake të komunës të bëhet në:

Në kategorinë e shpenzimeve **Subvencione dhe transfere** të rritet shuma për **98.179,64 €** në Kodin e programit: **160** Zyra e kryetarit – Nën-programi: **16008** Zyra e kryetarit

Në kategorinë e shpenzimeve **Investime kapitale** të rritet shuma për **100,000.00€** në nën-programet dhe projektet e mëposhtme:

Në programin **660** Planifikim urban – Nën-programi **66345** Planifikim urban të rritet shuma për **100,000.00€** në projektin e mëposhtëm:

- Që në kodin e projektit **53634** Ndërtimi ndërtesave për banim social të rritet shuma për **100,000,00€** si projekt i vjetër

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi janë përgjegjës: kryetari i komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Graçanicës.

Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević

